



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

**Ligji nr. 02/L-21**

**PËR SIGURINË E PËRGJITHSHME TË PRODUKTEVE**

Kuvendi i Kosovës,

Në bazë të Rregullores nr. 200/9 të datës 15 maj 2001 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë, kreu 5.1 (a), 9.1.1 dhe 9.1.26 (a), me qëllim të rregullimit të sigurisë së përgjithshme të produkteve që vendosen në treg dhe në harmoni me standardet e Bashkësisë Evropiane,

Miraton:

**LIGJIN PËR SIGURINË E PËRGJITHSHME TË PRODUKTEVE**

**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

1.1. Me këtë ligj rregullohet siguria e përgjithshme e produkteve që vihen në treg.

1.2. Ky ligj zbatohet për të gjitha produktet që sipas këtij ligji konsiderohen produkte, vetëm kur me ndonjë dispozitë tjetër të ligjit të zbatueshëm, nuk rregullon fushën e sigurisë së atij produkti të caktuar.

1.3. Nëse ligji i veçantë, apo dispozitat që dalin për zbatimin e atij ligji, rregullojnë fushën e sigurisë së produktit të caktuar, atëherë ky ligj zbatohet vetëm kur rreziket ose llojet e rrezikut për atë produkt, nuk janë parashikuar në atë ligj të veçantë, ose nga dispozitat që dalin prej tij.

**Neni 2**

Ky ligj nuk zbatohet për produktet e përdorura që porositen si antikitet ose për produktet që duhet të riparohen ose të përpunohen para përdorimit të tyre, me kusht që furnizuesi për këtë ta informojë qartë personin të cilit i është porositur produkti.

### Neni 3

Termat që përdoren në ligj kanë kuptime si vijon:

(i) **Produkt** nënkupton çdo lloj prodhimi, përfshirë produktin në kuadër të ofrimit të shërbimit, që i dedikohet konsumatorit ose që në kushte të parashikueshme do të mund të përdorej nga konsumatorët, madje edhe nëse nuk është i destinuar për ta, i dërguar ose është në dispozicion, me pagesë ose pa pagesë, në kuadër të çfarëdo veprimtarie tregtare, pa marrë parasysh a është i ri, i përdorur ose i riparuar.

(ii) **Produkt i sigurt** nënkupton çdo lloj produkti që në kushte normale ose në kushte të përcaktuara të përdorimit, duke përfshirë afatin e përdorimit dhe sipas nevojës të vënies në përdorim, kërkesat për montim dhe mirëmbajtje, nuk paraqet kurrfarë rrezikshmërie gjatë përdorimit i cili konsiderohet i përdorshëm në pajtim me shkallën e lartë të mbrojtjes dhe sigurisë të jetës dhe shëndetit të njeriut, veçanërisht duke marrë parasysh elementet si vijon:

-Karakteristikat e produktit, veçanërisht përbërja e tij, paketimi, udhëzimet për montim dhe sipas nevojës, montimi dhe mirëmbajtja,

-Ndikimin e ndonjë produkti në produktet e tjera në rastet kur është normale të përdoret së bashku me produkte të tjera,

-Ekspozimin e produktit, shënjimin e tij, me vërejtjet dhe udhëzimet e përdorimit të tij dhe heqjen e të gjitha shenjave të tjera ose njoftimet që kanë të bëjnë me atë produkt,

-Kategoritë e konsumatorëve që i ekspozohen rrezikut kur përdorin një produkt të caktuar, veçanërisht fëmijët dhe personat e moshuar. Mundësia e arritjes së shkallës së lartë të sigurisë ose ekspozimi ndaj produkteve të tjera që paraqesin rrezikshmëri më të vogël, nuk ndikojnë në kushtet që ndonjë produkt të konsiderohet i rrezikshëm.

(iii) **Produkt i rrezikshëm** është çdo produkt i cili nuk është në harmoni me definicionin nga paragrafi 1. pika (ii) e këtij neni.

(iv) **Rreziku serioz** nënkupton çdo rrezik që kërkon veprim të shpejtë të organeve të shtetit, duke përfshirë edhe rrezikun pasojat e të cilit nuk janë momentale.

(v) **Prodhues nënkupton:**

-Prodhuesi i produktit kur është i regjistruar në Kosovë dhe çdo person tjetër që paraqitet si prodhues që në produkt vë emrin, shenjën mbrojtëse të tij ose ndonjë shenjë tjetër dalluese, ose përpunon me themel produktin,

-Përfaqësuesi i prodhuesit, kur prodhuesi nuk është i regjistruar në Kosovë, ose kur nuk ka përfaqësues të regjistruar në Kosovë, importuesi i produktit,

-Personat e tjerë në hallkën e furnizimit, në masën në të cilën veprimtaritë e tyre mund të ndikojnë në karakteristikat e sigurisë së produktit.

(vi) **Shpërndarës** nënkupton çdo person në hallkën e furnizimit veprimtaria e të cilit nuk ndikon në karakteristikat e sigurisë së produktit.

(vii) **Tërheqje e produktit** nënkupton çdo masë të marrë për kthimin prapa të produktit të rrezikshëm të cilin prodhuesi ose shpërndarësi tashmë ja ka dërguar ose ofruar konsumatorit.

(viii) **Pengim i shpërndarjes** nënkupton çdo masë të marrë të drejtuar për pengimin e shpërndarjes, ekspozimit ose ofrimit të produktit konsumatorëve.

## II. KËRKESAT E PËRGJITHSHME TË SIGURISË PËR PRODUKTE

### Neni 4

4.1. Prodhuesi është i obliguar të nxjerrë në treg vetëm produkte të sigurta.

4.2. Në kuptim të paragrafit 1. të këtij neni produkti konsiderohet i sigurt:

- (i) kur i plotëson të gjitha kushtet e përfshira në rregullat teknike që kanë të bëjnë me të,
- (ii) nëse nuk ka rregulla përkatëse teknike dhe produkti i plotëson kërkesat e standardeve të Kosovës që merren nga standardet evropiane, që janë shpallur në “Gazetat zyrtare”,
- (iii) nëse nuk ekzistojnë standarde ose dispozita përkatëse teknike, që i referohen pikës paraprahe, por janë konform standardeve evropiane të përcaktuara me marrëveshje ndërkombëtare.

4.3. Nuk lejohet të prodhohen, të importohen, të eksportohen ose të qitën në treg produkte që kanë pamje mashtruese dhe për këtë arsye paraqesin pasiguri për konsumatorët, para së gjithash për fëmijë.

### Neni 5

5.1. Inspektorati i tregut me vendim ndalon të qitën në treg dhe të përdoren e produkte, gjegjësisht merr vendim për tërheqjen e tyre nga tregu, nëse vërteton që ato produkte, edhe pse i plotësojnë kushtet sipas dispozitave të nenit 4 paragrafi 2 i këtij ligji, rrezikojnë sigurinë e jetës dhe shëndetin e konsumatorit dhe të shfrytëzuesve të tjerë.

5.2. Ankesa, ose padia kundër vendimit nga paragrafi 1. i këtij neni nuk shtyn zbatimin e vendimit.

## III. DETYRIMET E PRODHUESIT DHE TË SHPËRNDARËSIT

### Neni 6

6.1. Që siguria e produktit të jetë e garantuar, prodhuesit ose shpërndarësit duhet:

- (i) T’i njoftojnë konsumatorët dhe shfrytëzuesit e tjerë, nëpërmjet udhëzimeve për përdorim që duhet të jenë të ekspozuara, dhe njoftimeve të tjera të nevojshme, në mënyrë që konsumatorët dhe shfrytëzuesit e tjerë do të mund t’i vlerësonin rreziqet e karakteristikave të produktit, gjatë afatit të paraparë të përdorimit të tyre, por kur rreziqet e tilla nuk vërehen pa një paralajmërim përkatës të marrin masa për kujdes ndaj atyre rreziqeve,
- (ii) Në pajtim me karakteristikat e produktit që dërgohet, merr masa adekuate që mundësojnë njoftimin për rreziqet që ato produkte mund të paraqesin dhe për marrjen e masave adekuate sipas nevojës edhe tërheqjen e produkteve nga tregu, në mënyrë që të shmangen rreziqet.

6.2. Kur prodhuesit dhe shpërndarësit janë në dijeni apo duhej ta kenë në dijeni se produktet që i kanë qitur në treg paraqesin rrezik për konsumatorët, që nuk janë në harmoni me kërkesat e përgjithshme të sigurisë, menjëherë për këtë duhet t'i njoftojnë organet kompetente.

6.3. Prodhuesit dhe konsumatorët, në suazat e veprimtarisë së tyre, bashkëpunojnë me organet kompetente në marrjen e masave me qëllim të shmangies së rreziqeve që paraqesin produktet që dërgohen ose tashmë janë dërguar.

6.4. Njoftimet nga paragrafi 1. pika (i) e këtij neni nuk e lirojnë askënd nga detyrimi për të vënë në treg vetëm produkte të sigurta.

#### IV. MBIKËQYRJA

##### Neni 7

7.1. Inspektorët e tregut mbikëqyrin zbatimin e dispozitave të këtij ligji, në pajtim me këtë ligj dhe me ligje të tjera, ku përcaktohen detyrat dhe autorizimet e inspektorëve të tregut.

7.2. Inspektorët e tregut, përveç autorizimeve për marrjen e masave që dalin nga dispozita të veçanta që kanë të bëjnë me punën e tyre në bazë të këtij Ligji, kanë edhe autorizime shtesë si:

- (i) Për çfarëdo produkti:
- (ii) organizojnë, madje edhe pasi këto produkte të qiten në treg si të sigurta, me verifikim përkatës të karakteristikave në shkallë të caktuar të sigurisë së tyre gjatë gjithë kohës deri në fazën e fundit të përdorimit,
- (iii) t'i kërkojnë të gjitha informatat e nevojshme nga ata të cilëve kjo u përket,
- (iv) t'i marrin mostrat e produkteve dhe t'i dërgojnë tu nënshtrohen provave të sigurisë,
- (v) për çfarëdo produkti që mund të paraqesë rrezik në kushte të caktuara:
- (vi) të kërkojnë që produkti të jetë i pajisur me paralajmërime të theksuara qartë dhe lehtë të kuptueshme në gjuhën zyrtare për rreziqet që mund t'i paraqes produkti,
- (vii) të krijojnë kushte për qitjen e produktit në treg në mënyrë që ai të jetë i sigurt,
- (viii) për çfarëdo produkti që do të mund të paraqiste rreziqe për persona të caktuar:
- (ix) udhëzimet si këta persona të jenë të informuar në kohën e duhur për rreziqet e tilla, përfshirë ekspozimin e paralajmërimeve të veçanta,
- (x) për çfarëdo produkti që do të mund të ishte i rrezikshëm:

- (xi) përkohësisht, në periudhën e nevojshme për kontroll, verifikime dhe për vlerësime të sigurisë, për ndalimin e dërgesës, të ofertës së dërgesës ose për ekspozimin,
- (xii) për çfarëdo produkti të rrezikshëm:
- (xiii) ndalimin e qitjes së tij në treg dhe marrjen e masave përkatëse të nevojshme që të sigurohet respektimi i këtyre masave,
- (xiv) për çfarëdo produkti të rrezikshëm, që tashmë është në treg:
- (xv) të urdhërohet ose të organizohet tërheqja e menjëhershme dhe efektive nga tregu dhe të paralajmërohen shfrytëzuesit për rreziqet që ai paraqet,
- (xvi) të urdhërojnë, të harmonizojnë apo sipas nevojës, të organizojnë së bashku me prodhuesit dhe me shpërndarësit tërheqjen e tyre prej prodhuesit dhe asgjësimin e tyre në kushte përkatëse.

7.3. Kur inspektorati i tregut merr masa nga paragrafi 2. i këtij neni, veçanërisht ato që ceken në pikat (x) - (xii), duhet të veprohet ashtu që të zbatohen ato masa në mënyrë proporcionale sipas seriozitetit të rrezikut duke pasur parasysh parimet e sigurisë.

7.4. Nëse inspektorati i tregut nuk ka njohuri profesionale përkatëse ose pajisje për zbatimin e shqyrtimeve të nevojshme nga paragrafi 2. i këtij neni, dhe për zbatimin e disa veprimeve të veçanta në kuadër të mbikëqyrjes inspektuese mund t'ua besojë institucioneve të aftësuara për këtë lloj veprimtarie.

7.5. Shpenzimet e procedurës së inspektimit, të bëra gjatë zbatimit të procedurës së mbikëqyrjes, i heqë prodhuesi ose importuesi, nëse vërtetohet se produkti nuk ka qenë i sigurt, si pasojë e gabimeve të bëra nga ana e tyre.

#### Neni 8

Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë, brenda 6 muajve nga dita e shpalljes së këtij ligji, nxjerr udhëzim administrativ që rregullon përmbajtjen dhe procedurën e njoftimit dhe informimin e organeve të tjera qeveritare, të subjekteve ndërkombëtare dhe të publikut, në lidhje me rreziqet që i kanosen shëndetit ose sigurisë së njerëzve nga produktet e qitura në treg, dhe masat që merren për tërheqjen e këtyre produkteve nga tregu. Përmbajtja e këtij udhëzimi administrativ do të parashihet detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit për mbrojtjen e konsumatorëve, të inspektoratit të tregut dhe të organeve të tjera përkatëse përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe krijimin e kushteve ushqimore, higjienike dhe sanitare.

### V. DISPOZITAT NDËSHKIMORE

#### Neni 9

9.1. Në bazë të një table që e lëshon Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, me gjobë prej 2.000 deri në 20.000 Euro dënohen personat juridikë, përkatësisht me gjobë prej 200 deri në 2.000 Euro personat fizikë që:

- (i) në kundërshtim me nenin 4. paragrafi 1 i këtij ligji qesin në treg produkte që nuk janë të sigurta,
- (ii) në kundërshtim me nenin 4. paragrafi 3. të këtij ligji qesin në treg ose ofrojnë për konsum produkte të rrezikshme,

(iii) në kundërshtim me nenin 6. të këtij ligji nuk njoftojnë në mënyrë adekuate konsumatorët ose shfrytëzuesit tjerë ose nuk ndërmarrin masa adekuate për t'i shmangur rreziqet,

(iv) në kundërshtim me nenin 7. të këtij ligji nuk veprojnë në pajtim me vendimet ekzekutive të organeve inspektuese të autorizuar.

9.2. Me gjobë prej 200 deri 2.000 Euro dënohet për kundërvajtje edhe personi përgjegjës i personit juridik që bënë kundërvajtjen nga paragrafi paraprak.

9.3. Të gjitha pagesat që rrjedhin nga zbatimi i dispozitave të këtij ligji derdhen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

## VI. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

### Neni 10

Procedurat ndëshkimore që kanë filluar deri ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji do të kryhen sipas dispozitave që kanë qenë në fuqi deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji.

### Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Kosovës dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

**Ligji Nr. 02/L-21**  
**20 maj 2005**

**Kryetari i Kuvendit të Kosovës,**  

---

**akademik Nexhat Daci**